

REPUBLIKA E SHIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 8157 Kol.
Nr. 1363 Rep.



KONTRATË

SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 30.10. 2001, para meje Agim Robo, Noter i Dhomës së Noterisë Tiranë u paraqitën personalish, shtetasi shqiptar, Ylli Guri, ortak i vetëm i shoqërisë "ERJONI" Sh.p.k. me cilësinë e shitësit dhe shtetasi Irfan Hysenbelliu, me cilësinë e blerësit, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit-Blerje kuotash me termat e mëposhtëm :

SHITËS : Ylli Guri, i datëlindjes 30.07.1955, lindur në Skrapar, banues në adresën: lagjia "Pavarsia", Pall.1383, Vlorë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të veptuar, mbajtës i letër njoftimit me nr.00207.

BLERËS : Irfan Hysenbelliu, i datëlindjes 08.04.1959, lindur në Skrapar dhe banues në Tiranë Rruga "Pjetër Bogdani", Pall.11, Ap.6, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr.299990.

OBJEKTI : Shitja e kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare "ERJONI" Sh.p.k. në masën 100%.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria Tregtare "ERJONI" sh.p.k. është rregjistruar në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Tiranës me Vendim nr.7877, datë.05.01.1995.

Shoqëria është themeluar me një kapital prej 100.000 lekë dhe me ortak të vetëm themelues, shtetasin shqiptar, Ylli Guri.

Agim Robo
2001

Ylli Guri

Me vendim datë 25.10.2001 të ortakut të vetëm të shoqërisë tregtare "ERJONI" sh.p.k. është vendosur shitja e kuotave në masën 100% të kapitalit themeltar, për belresin z.Ifran Hysenbelliu.

Shitja e kuotave të kapitalit themeltar në masën 100%, përbën humbjen e të drejtës së pronësisë së ortakut të vetëm, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, shprehur dhe në vendimin e mësipërm të ortakut të vetëm.

Shitësi Ylli Guri është plotësisht dakort dhe shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **Blerësit** Ifran Hysenbelliu, vlerën 100% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Nga ana e tij **Blerësi** Ifran Hysenbelliu, është plotësisht dakort që të blejë masën 100% të kuotave që i takon **Shitësit** Ylli Guri në kapitalin themeltar të shoqërisë "ERJONI" sh.p.k.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE.



Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi Ylli Guri, e humbet pronësinë mbi masën 100% të kuotave dhe Blerësi Ifran Hysenbelliu bëhet zotërues i kësaj pjese, duke zëvendësuar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përftohen nga ky transaksion shit-blerjeje, ortakun e vetëm të shoqërisë "ERJONI" sh.p.k.

Shoqëria tregtare "ERJONI" sh.p.k., pas realizimit të kësaj kontrate shit-blerjeje do të ketë si ortak të vetëm të saj Z.Ifran Hysenbelliu me pjesmarrije 100% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE .

Si çmim i këtij transaksioni shit-blerje të kuotave të shoqërisë tregtare "ERJONI" sh.p.k. do të jetë ai i vlerës nominale të një kuote. Vlera nominale e një kuote është 1000 lekë.

Sipas këtij përcaktimi blerësi paguan në favor të shitësit shumë prej 100.000 lekë, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre.



DISPOZITA TË FUNDIT


Kontrata hartohet në pesë kopje të njëjta, një depozitohet në Zyrën e Rregjistrimit Tregtar, një kopje depozitohet në Aktet e Shoqërisë, një kopje pranë Zyrës së Noterit ku ajo u redaktua dhe nga një kopje e mbajnë palët.

Termat e Kontratës pasi u redaktua prej meje Noterit iu bënë të ditur palëve kontraktuese të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, në prezencën time.

PALËT


SHITËSI

Ylli GURI



BLERËSI

Ifra HYSENBELLIU



NOTER

Agim ROBO

